

KLSH organizon në Universitetin “Fan S. Noli” workshop-in për përgatitjen e planit të auditimeve për vitin 2024

15.11.2023

Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi në Universitetin “Fan S. Noli”, workshop-in për hartimin e planit të auditimeve për vitin 2024.

Në workshop-in e zhvilluar në datën 15.11.2023 në ambientet e Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Korçës, morën pjesë auditues të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe auditues nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional në KLSH.

Në këtë workshop ishin të pranishme deputetja e Kuvendit të Shqipërisë, anëtare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, znj. Enslemvera Zake dhe dekania e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin “Fan S. Noli”, znj. Ledina Alolli. Në fjalën e saj, znj. Zake, pasi shprehu vlerësimin për punën dhe kontributin e institucionit të KLSH-së për rritjen e transparencës dhe mirëadministrimit të fondeve dhe pasurisë publike, solli në vëmendje aspekte të ndryshme të punës për rritjen e vëmendjes në trajtimin e duhur të ankesave të qytetarëve, si dhe evidentoi rëndësinë e publikimeve të raporteve të auditimit në faqen zyrtare të KLSH-së etj.



Gjatë fjalës së përshëndetjes, nga dekania e Fakultetit të Ekonomisë, znj. Alolli, u theksua roli dhe kontributi i KLSH-së për nevojën në publikimin dhe shkëmbimin e të dhënave në ndihmë të kërkimeve të punës së thelluar shkencore në universitete dhe konkretisht me Fakultetin e Ekonomisë.

Në sesionin e parë të workshop-it u paraqitën prezantimet e drejtorit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, z. Gjovalin Preçi, si dhe të drejtorit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, z. Qeram Cibaku, të cilët u ndalën në aspektet e kuadrit ligjor, rregullativ, standardeve ndërkombëtare të auditimit ISSAI, të lidhura me hapat proceduriale dhe procesin e hartimit të planit vjetor të auditimeve.

Prezantimet kishin vëmendje të veçantë në zbatimin e misionit kushtetues, si dhe të ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për aktivitetin auditues në

njësitë publike, në kohën dhe njësinë e duhur, duke gjeneruar vlerë të shtuar në menaxhimin e financave dhe pronës publike, në rritjen e profesionalizimit të administratës publike, si dhe të analizës së riskut.



KLSH harton një plan të detajuar me bazë risku për vitin e ardhshëm duke përcaktuar projektet, aktivitetet, afatet kohore të planifikuara, si dhe burimet e nevojshme për realizimin e aktivitetit auditues të parashikuar, buxhetin e përafërt, përgjegjësinë për projektet dhe rreziqet e përfshira. Në prezantime u theksua se ky proces duhet të fillojë me identifikimin e subjekteve dhe fushave të auditimit, kontributin e aktorëve kryesorë, nivelin e mbulimit me auditim dhe ndikimin e tij, si dhe duke marrë parasysh tendencat dhe zhvillimet e reja.

Gjithashtu, gjatë prezantimeve u paraqitën edhe detyrat që rrjedhin nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e KLSH-së, si *“rritje e ekspertizës profesionale në veprimtarinë audituese, programim në periodikë për institucionet e pavarura, si dhe rritje të auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe auditimeve të mjedisit për sa i takon fushave që lidhen me sulmet kibernetike, ndryshimet klimatike, menaxhimin e mbetjeve dhe financimin e mbrojtjes së mjedisit”*.

Gjatë prezantimit nga ana e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit u sollën në vëmendje të audituesve edhe kufizimet lidhur me planifikimin dhe kryerjen e auditimeve, të kushtëzuara me kohën e Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik, i cili përgatitet nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Me qëllim gjenerimin e ideve dhe të propozimeve për auditime, të cilat i shërbejnë hartimit të planit vjetor të auditimeve për vitin 2024, nga ana e drejtorëve të departamenteve, u sollën në vëmendje çështjet që kanë të bëjnë me Metodologjinë e Planifikimit Vjetor të Auditimeve, si dhe dhënien e kontributit në përmirësimin e punës audituese nga të gjithë audituesit.

Audituesit e pranishëm në workshop diskutuan për çështje të lidhura me planifikimin e auditimeve në nivel subjektsh, llojesh auditimi, si dhe në programimin e drejtimeve brenda tyre.

Gjithashtu, u paraqitën edhe synimet e departamenteve lidhur me përmirësimin e punës planifikuese/audituese, të tilla si:

- Përmirësimi i planifikimit të auditimeve 2024, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë audituese të KLSH-së në drejtim të parandalimit, zbulimit dhe ndëshkimit të parregullsive ekonomike dhe financiare.

- Një planifikim i saktë, korrekt dhe i domosdoshëm për llojet e auditimit dhe subjektet e auditimit për arritjen e objektivave përbën garanci në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit.
- Planifikimi i auditimeve si një proces gjithëpërfshirës, i cili realizohet dhe finalizohet me kontributin e të gjithë audituesve të KLSH-së.

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë së Auditimit dhe Zbatimit të Standardeve, z. Bexhet Zeqiri, e vuri theksin në përfshirjen në planifikim të atyre subjekteve që kanë rol të rëndësishëm në hartimin e Raportit të Zbatimit të Buxhetit të Shtetit që përgatitet nga KLSH, krahas përmirësimit të cilësisë së auditimeve në përgjithësi.